

### Njoftim për kërkim kandidaturash për ndjekje kualifikimesh

1	Titulli i kursit	Kursi i avancuar i komandës dhe shtabit.
2	Kriteret e kërkuara të gradës	Të jenë oficerë me gradë major – nënkolonel,
3	Kriteret e kërkuara të gjuhës / gjuhëve	Anglisht 3/3/3 sipas STANAG 6001, mbi 90 pikë në ALCPT, IELTS niveli 7 (nivel Akademik)
4	Përshkrimi	Kursi ka për qëllim të arsimojë oficerë të përzgjedhur për t'u emëruar në pozicione drejtuese, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive të tyre analitike, vendimmarrëse dhe komunikuese si dhe në zgjerimin e njohurive mbi perspektivën e tyre profesionale nëpërmjet një vlerësimi më të thellë të operacioneve, zotërimit të plotë të strategjisë së sigurisë dhe mbrojtjes në një kontekst politik, ndërkombëtar dhe financiar.
5	Periudha e zhvillimit të kursit	24 gusht 2020 – 16 qershor 2021
6	Vendi i zhvillimit të kursit	Mbretëria e Bashkuar
7	Afati aplikimit elektronik (sipas lidhjes 4)	<b>7 janar 2020</b>
8	Ekuivalentimi	K 5 – K 6
9	Të tjera	Kandidatët duhet të flasin rrjedhshëm gjuhën angleze dhe të kenë një fjalor të pasur me terma politik, ekonomik dhe ushtarak; të jenë plotësisht të familjarizuar me një shërbim të caktuar ose doktrinën kombëtare; të kenë njohuri mbi procesin e vlerësimit të mjedisit në këtë shërbim; të njohin me detaje shërbimin e tyre ose strukturat e kontrollit dhe drejtimit, si dhe doktrinën në nivel operacional. Për kandidatët të cilët kanë nivelin e gjuhës angleze 3/2/3/2 sipas STANAG 6001, mbi 80 pikë në ALCPT, IELTS niveli 6, ofrohet një kurs gjuhe në periudhën Maj – Gusht 2020.
10	Kuota	një (1) kuotë